



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2021

VENDIM
Nr. 522, datë 03.11.2021

PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE TË SKEMËS SË DELEGIMIT PËR GJYKIMIN E DY
ÇËSHTJEVE GJYQËSORE NË GJYKATËN E POSAÇME TË APELIT PËR
KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në shkronjën “a”, të pikës 4 dhe pikën 7, të nenit 45, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 13, të Vendimit të tij nr. 22, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, pas shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, dërguar me Shkresën nr. 449 prot., datë 29.10.2021, protokolluar në Këshill me aktin nr. 5019 Prot., datë 01.11.2021 dhe Shkresën nr.446 Prot., datë 02.11.2021, protokolluar në Këshill me aktin nr.5041 Prot., datë 02.11.2021, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe mbas shortit të hedhur,

VENDOSI:

1. Gjyqtari i skemës së delegimit z. Engert Pëllumbi caktohet për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}; Akuza: “Për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 259, 248 të Kodit Penal”;
2. Gjyqtari i skemës së delegimit znj. Igerta Hysi caktohet për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar çështjen penale me të pandehur: {...}, etj.; Akuza: “Për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 283/1, 283/a/2, 28/4, 333/a/2, 334 të Kodit Penal”.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarëve z. Engert Pëllumbi dhe znj. Igerta Hysi, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR